

VENDIM
Nr. 147, datë 24.6.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 95/2 prot., datë 22.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi “Licencimin e shoqërisë ‘INFO-Telecom’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 136, datë 7.6.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE me shkresën nr. 6/15 prot., datë 8.6.2021, ka bërë publikimin në median e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 21.6.2021), nuk rezultuan vërejtje apo ankesa nga palët e interesuara.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 713/1 prot., datë 9.6.2020, ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Referuar deklaratës së shoqërisë rezultoi se ajo kryen dhe veprimtari të tjera, e konstatuar edhe në përmbajtjen e ekstraktit të QKB-së, shoqëria do të orientohet të mbajë llogari të ndarë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Aplikimi i shoqërisë rezultoi se plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

2. Të licencojë shoqërinë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti